



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.611/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi, kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Kujtim Pasuli anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e kandidatit për deputet Edmond Hoxha nga Koalicioni politik AAK-NISMA me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë administrimit dhe numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Komunën e Prizrenit, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 26.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHEN TE PASAFATSHME ankesat A.nr.611/2025, Anr.612/2025, Anr.613/2025, Anr.614/2025, Anr.615/2025, Anr.616/2025, Anr.617/2025, Anr.618/2025, Anr.619/2025, dhe Anr.620/2025 të parashtruara nga kandidati për deputet Edmond Hoxha nga Koalicioni AAK-NISMA me seli në Prishtinë, paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë administrimit dhe numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit në Komunën e Prizrenit, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09 Shkurt 2025.

A r s y e t i m

Me datë 26.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat A.nr.611/2025, Anr.612/2025, Anr.613/2025, Anr.614/2025, Anr.615/2025, Anr.616/2025, Anr.617/2025, Anr.618/2025, Anr.619/2025, dhe Anr.620/2025 të parashtruara nga kandidati për deputet Edmond Hoxha nga Koalicioni AAK-NISMA.

Në ankesën Anr.611-2025 theksohet se si kandidat për deputet për Parlamentin e Kosovës nga koalicioni AAK-NISMA kam pranuar informacione nga vëzhguesit se dhe përkundër votave të cilat janë vërejtur në disa prej fletëvotimeve në vendvotimin me numër 2055/01 në Prizren, nuk janë transferuar me dashje apo pa dashje votat e numrit 98 në sistem elektronik gjatë procesit të numërimit në QKN. Prandaj rezulton se në listën e votave të kandidatëve nga subjekti AAK-NISMA për numrin 98 figuron zero. Parashtruesi si dëshmi për mbështetjen e deklarimeve të mësipërme e ka bashkangjitur Deklaratën e vëzhgueses së caktuar nga Koalicioni AAK-NISMA Mirjeta Hoxha që ka dëshmuar lidhur me këtë parregullsi në administrimin e të dhënave nga fletvotimi në sistemin elektronik. Në deklaratën e saj bashkangjitur ankesës e njëjta thekson deklaroj se në cilësinë e vëzhguesit të caktuar nga

Koalicioni AAK-NISMA në zgjedhjet parlamentare të datës 09 Shkurt 2025, kam kryer detyrën e vëzhguesit në QKN në Prizren dhe kam vërejtur parregullsi në procesin e administrimit dhe numërimit në QKN në Prizren. Me përgjegjësi të plotë deklaroj se, gjatë verifikimit të fletëvotimeve të Koalicionit AAK-NISMA përmes paraqitjes në kamerë, kam vërejtur se përkundër votave të cilat kanë qenë në disa prej fletëvotimeve në vendvotimin me numër 2055/01 në Prizren, nuk janë transferuar me dashje apo pa dashje votat e numrit 98 në sistem elektronik gjatë procesit të numërimit në QKN në Prizren. Prandaj rezultati në listën e votave të kandidatëve nga Koalicioni AAK-NISMA për numrin 98 figuron zero.

Në ankesën Anr.612/2025 theksohet se si kandidat për deputet kam pranuar informacione nga vëzhguesit se edhe përkundër votave të cilat janë vërejtur prej disa fletvotimeve në vendvotimin me numër 2033/02 në Prizren nuk janë transferuar me dashje apo padashje votat e numrit 98 në sistemin elektronik gjatë procesit të numërimit në QKN. Prandaj rezultati në listën e votave të kandidatëve nga Koalicioni AAK-NISMA për numrin 98 figuron zero. Parashtruesi i ankesës si provë për mbështetjen e deklarimeve të veta ka bashkangjitur Deklaratën e Vëzhguesit të caktuar nga Koalicioni AAK-NISMA Merdin Përzhella i cili ka deklaruar: se në cilësinë e vëzhguesit të caktuar nga Kolaicioni AAK-NISMA në zgjedhjet parlamentare të datës 09 Shkurt 2025, kam kryer detyrën e vëzhguesit në QKN në Prizren dhe kam vërejtur parregullsi në procesin e administrimit dhe numërimit në QKN në Prizren. Me përgjegjësi të plotë deklaroj se, gjatë verifikimit të fletëvotimeve të Kolaicionit AAK-NISMA përmes paraqitjes në kamerë, kam vërejtur se përkundër votave të cilat kanë qenë në disa prej fletëvotimeve në vendvotimin me numër 2033/02 në Prizren, nuk janë transferuar me dashje apo pa dashje votat e numrit 98 në sistem elektronik gjatë procesit të numërimit në QKN në Prizren. Prandaj rezultati në listën e votave të kandidatëve (FRK) nga Kolaicioni AAK-NISMA për numrin 98 figuron zero.

Në ankesën Anr.613/2025 theksohet si kandidat për deputet kam pranuar informacione nga vëzhguesit se edhe përkundër votave të cilat janë vërejtur në disa fletëvotime në vendvotimin me numër 2003/03 në Prizren, nuk janë transferuar me dashje apo pa dashje votat e numrit 98 në sistemin elektronik gjatë procesit të numërimit në QKN. Prandaj rezultoni se në listën e votave të kandidatëve nga Koalicioni AAK-NISMA për numrin 98 figuron zero. Parashtruesi i ankesës ka theksuar se kërkon që ankesa e tij të merret parasysht duke rinumëruar vendvotimin me numër 2003/03 vetëm fletëvotimet e Koalicionit 137 AAK-NISMA. Për të mbështetur deklarinmet e mësipërme parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur Deklaratën e vëzhgueses së caktuar nga Kolaicioni AAK-NISMA Brikena Hoxha e cila deklaron, se në cilësinë e vëzhguesit të caktuar nga Kolaicioni AAK-NISMA në zgjedhjet parlamentare të datës 09 Shkurt 2025, kam kryer detyrën e vëzhguesit në QKN në Prizren dhe kam vërejtur parregullsi në procesin e administrimit dhe numërimit në QKN në Prizren. Me përgjegjësi të plotë deklaroj se, gjatë verifikimit të fletëvotimeve të Koalicionit AAK-NISMA përmes paraqitjes në kamerë, kam vërejtur se përkundër votave të cilat kanë qenë në disa prej fletëvotimeve në vendvotimin me numër 2003/03 në Prizren, nuk janë transferuar me dashje apo pa dashje votat e numrit 98 në sistem elektronik gjatë procesit të numërimit në QKN në Prizren. Prandaj rezultati në listën e votave të kandidatëve (FRK) nga Koalicioni AAK-NISMA për numrin 98 figuron katër.

Në ankesën Anr.614/2025 theksohet se si kandidat për kam pranuar informacione nga vëzhguesit se edhe përkunder votave të cilat janë vërejtur në disa fletëvotime në vendvotimin me numër 2075/06 në Prizren, nuk janë transferuar me dashje apo pa dashje votat e numrit 98 në sistemin elektronik gjatë procesit të numërimit në QKN. Prandaj rezulton se në listën e votave të kandidatëve nga Koalicioni AAK-NISMA për numrin 98 figuron vetëm dy. Parashtruesi i ankesës thekson se kërkon rinumërimin në vendvotimin me numër 2075/06 vetëm të Koalicionit AAK-NISMA. Për të mbështetur deklaratimet e veta parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi deklaratën e vëzhguesit Merdin Përzhella i cili deklaron: se në cilësinë e vëzhguesit të caktuar nga Kolaicioni AAK- NISMA në zgjedhjet parlamentare të datës 09 Shkurt 2025, kam kryer detyrën e vëzhguesit në QKN në Prizren dhe kam vërejtur parregullsi në procesin e administrimit dhe numërimit në QKN në Prizren. Me përgjegjësi të plotë deklaroj se, gjatë verifikimit të fletëvotimeve të Kolaicionit AAK-NISMA përmes paraqitjes në kamerë, kam vërejtur se përkundër votave të cilat kanë qenë në disa prej fletëvotimeve në vendvotimin me numër 2075/06 në Prizren, nuk janë transferuar me dashje apo pa dashje votat e numrit 98 në sistem elektronik gjatë procesit të numërimit në QKN në Prizren. Prandaj rezultati në listën e votave të kandidatëve nga Kolaicioni AAK-NISMA për numrin 98 figuron dy.

Në ankesën 615/2025 theksohet si kandidat për kam pranuar informacione nga vëzhguesit se edhe përkundër votave të cilat janë vërejtur në disa fletëvotime në vendvotimin me numër 2029/01 në Prizren, nuk janë transferuar me dashje apo pa dashje votat e numrit 98 në sistemin elektronik gjatë procesit të numërimit në QKN. Prandaj rezulton se në listën e votave të kandidatëve nga Koalicioni AAK-NISMA për numrin 98 figuron vetëm dy. Parashtruesi i ankesës ka kërkuar rinumërimin në vendvotimit 2029/01 vetëm për Kolaicionin AAK-NISMA. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur deklaratën e vëzhgueses Mirjeta Hoxha e cila deklaron: se në cilësinë e vëzhguesit të caktuar nga Kolaicioni AAK-NISMA në zgjedhjet parlamentare të datës 09 Shkurt 2025, kam kryer detyrën e vëzhguesit në QKN në Prizren dhe kam vërejtur parregullsi në procesin e administrimit dhe numërimit në QKN në Prizren.Me përgjegjësi të plotë deklaroj se, gjatë verifikimit të fletëvotimeve të Kolaicionit AAK-NISMA përmes paraqitjes në kamerë, kam vërejtur se përkundër votave të cilat kanë qenë në disa prej fletëvotimeve në vendvotimin me numër 2029/01 në Prizren, nuk janë transferuar me dashje apo pa dashje votat e numrit 98 në sistem elektronik gjatë procesit të numërimit në QKN në Prizren. Prandaj rezultati në listën e votave të kandidatëve (FRK) nga Kolaicioni AAK-NISMA për numrin 98 figuron dy.

Në ankesën Anr.616/2025 theksohet se si kandidat për kam pranuar informacione nga vëzhguesit se edhe përkunder votave të cilat janë vërejtur në disa fletëvotime në vendvotimin me numër 2006/03 në Prizren, nuk janë transferuar me dashje apo padashje votat e numrit 98 në sistemin elektronik gjatë procesit të numërimit në QKN.Prandaj rezulton se në listën e votave të kandidatëve nga Koalicioni AAK-NISMA për numrin 98 figuron vetëm dy. Parashtruesi i ankesës ka kërkuar rinumërimin në vendvotimit 2006/03 vetëm për Kolaicionin AAK-NISMA. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur deklaratën e vëzhgueses Mirjeta Hoxha e cila deklaron: se në cilësinë e vëzhguesit të caktuar nga Koalicioni AAK-NISMA në zgjedhjet parlamentare të datës 09 Shkurt 2025, kam kryer detyrën e vëzhguesit në QKN në Prizren dhe kam vërejtur parregullsi në procesin e administrimit dhe numërimit në QKN në Prizren.Me përgjegjësi të plotë deklaroj se, gjatë verifikimit të fletëvotimeve të

Koalicioni AAK-NISMA përmes paraqitjes në kamerë, kam vërejtur se përkundër votave të cilat kanë qenë në disa prej fletëvotimeve në vendvotimin me numër 2006/03 në Prizren, nuk janë transferuar me dashje apo pa dashje votat e numrit 98 në sistem elektronik gjatë procesit të numërimit në QKN në Prizren. Prandaj rezultati në listën e votave të kandidatëve (FRK) nga Kolaicioni AAK-NISMA për numrin 98 figuron dy.

Në ankesën Anr.617/2025 theksohet se si kandidat për kam pranuar informacione nga vëzhguesit se edhe përkunder votave të cilat janë vërejtur në disa fletëvotime në vendvotimin me numër 2018/02 në Prizren, nuk janë transferuar me dashje apo pa dashje votat e numrit 98 në sistemin elektronik gjatë procesit të numërimit në QKN. Prandaj rezultoni se në listën e votave të kandidatëve nga Koalicioni AAK-NISMA për numrin 98 figuron vetëm dy. Parashtruesi i ankesës ka kërkuar rinumërimin në vendvotimit 2018/02 vetëm për Kolaicionin AAK-NISMA. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur deklaratën e vëzhgueses Brikena Hoxha e cila deklaron: se në cilësinë e vëzhguesit të caktuar nga Kolaicioni AAK-NISMA në zgjedhjet parlamentare të datës 09 Shkurt 2025, kam kryer detyrën e vëzhguesit në QKN në Prizren dhe kam vërejtur parregullsi në procesin e administrimit dhe numërimit në QKN në Prizren. Me përgjegjësi të plotë deklaroj se, gjatë verifikimit të fletëvotimeve të Koalicionit AAK-NISMA përmes paraqitjes në kamerë, kam vërejtur se përkundër votave të cilat kanë qenë në disa prej fletëvotimeve në vendvotimin me numër 2018/02 në Prizren, nuk janë transferuar me dashje apo pa dashje votat e numrit 98 në sistem elektronik gjatë procesit të numërimit në QKN në Prizren. Prandaj rezultati në listën e votave të kandidatëve (FRK) nga Koalicioni AAK-NISMA për numrin 98 figuron dy.

Në ankesën Anr.618/2025 theksohet se si kandidat për kam pranuar informacione nga vëzhguesit se edhe përkundër votave të cilat janë vërejtur në disa fletëvotime në vendvotimin me numër 2066/02 në Prizren, nuk janë transferuar me dashje apo pa dashje votat e numrit 98 në sistemin elektronik gjatë procesit të numërimit në QKN. Prandaj rezultoni se në listën e votave të kandidatëve nga Koalicioni AAK-NISMA për numrin 98 figuron vetëm katër. Parashtruesi i ankesës ka kërkuar rinumërimin në vendvotimit 2066/02 vetëm për Kolaicionin AAK-NISMA. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur deklaratën e vëzhgueses Edita Sopaj Hoxha e cila deklaron: se në cilësinë e vëzhguesit të caktuar nga Kolaicioni AAK-NISMA në zgjedhjet parlamentare të datës 09 Shkurt 2025, kam kryer detyrën e vëzhguesit në QKN në Prizren dhe kam vërejtur parregullsi në procesin e administrimit dhe numërimit në QKN në Prizren. Me përgjegjësi të plotë deklaroj se, gjatë verifikimit të fletëvotimeve të Kolaicionit AAK-NISMA përmes paraqitjes në kamerë, kam vërejtur se përkundër votave të cilat kanë qenë në disa prej fletëvotimeve në vendvotimin me numër 2066/02 në Prizren, nuk janë transferuar me dashje apo pa dashje votat e numrit 98 në sistem elektronik gjatë procesit të numërimit në QKN në Prizren. Prandaj rezultati në listën e votave të kandidatëve (FRK) nga Koalicioni AAK-NISMA për numrin 98 figuron dy.

Në ankesën Anr.619/2025 theksohet se si kandidat për kam pranuar informacione nga vëzhguesit se edhe përkunder votave të cilat janë vërejtur në disa fletëvotime në vendvotimin me numër 2003/05 në Prizren, nuk janë transferuar me dashje apo pa dashje votat e numrit 98 në sistemin elektronik gjatë procesit të numërimit në QKN. Prandaj rezultoni se në listën e votave të kandidatëve nga Koalicioni AAK-NISMA për numrin 98 figuron vetëm dy. Parashtruesi i ankesës ka kërkuar rinumërimin në vendvotimit 2003/05 vetëm për Kolaicionin

AAK-NISMA. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur deklaratën e vëzhgueses Edita Sopaj Hoxha e cila deklaron: se në cilësinë e vëzhguesit të caktuar nga Koalicioni AAK-NISMA në zgjedhjet parlamentare të datës 09 Shkurt 2025, kam kryer detyrën e vëzhguesit në QKN në Prizren dhe kam vërejtur parregullsi në procesin e administrimit dhe numërimit në QKN në Prizren. Me përgjegjësi të plotë deklaroj se, gjatë verifikimit të fletëvotimeve të Kolaicionit AAK-NISMA përmes paraqitjes në kamerë, kam vërejtur se përkundër votave të cilat kanë qenë në disa prej fletëvotimeve në vendvotimin me numër 2003/05 në Prizren, nuk janë transferuar me dashje apo pa dashje votat e numrit 98 në sistem elektronik gjatë procesit të numërimit në QKN në Prizren. Prandaj rezultati në listën e votave të kandidatëve (FRK) nga Kolaicioni AAK-NISMA për numrin 98 figuron dy.

Në ankesën Anr.620/2025 theksohet se si kandidat kam pranuar informacione nga vëzhguesit se edhe përkunder votave të cilat janë vërejtur në disa fletëvotime në vendvotimin me numër 2028/01 në Prizren, nuk janë transferuar me dashje apo padashje votat e numrit 98 në sistemin elektronik gjatë procesit të numërimit në QKN. Prandaj rezulton se në listën e votave të kandidatëve nga koalicioni AAK-NISMA për numrin 98 figuron zero. Parashtruesi i ankesës ka kërkuar rinumërimin në vendvotimit 2003/05 vetëm për koalicionin AAK-NISMA. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur deklaratën e vëzhguesit Merdin Përzhella i cili deklaron: se në cilësinë e vëzhguesit të caktuar nga Kolaicioni AAK-NISMA në zgjedhjet parlamentare të datës 09 Shkurt 2025, kam kryer detyrën e vëzhguesit në QKN në Prizren dhe kam vërejtur parregullsi në procesin e administrimit dhe numërimit në QKN në Prizren. Me përgjegjësi të plotë deklaroj se, gjatë verifikimit të fletëvotimeve të Kolaicionit AAK-NISMA përmes paraqitjes në kamerë, kam vërejtur se përkundër votave të cilat kanë qenë në disa prej fletëvotimeve në vendvotimin me numër 2028/01 në Prizren, nuk janë transferuar me dashje apo pa dashje votat e numrit 98 në sistem elektronik gjatë procesit të numërimit në QKN në Prizren. Prandaj rezultati në listën e votave të kandidatëve (FRK) nga Kolaicioni AAK-NISMA për numrin 98 figuron zero.

Në përgjigje në ankesë nga KQZ theksohet Bazuar në këtë fazë të procesit zgjedhor kur ankesa është dorëzuar në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), e parashtruar lidhur me administrimin në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), si dhe për mungesën e votave në vendvotimet e specifikuar në ankesë, nuk mund të procedohet si ankesë e afatëshme, sepse në kuptim të nenit 105 paragrafi 1 Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nenin 105 paragrafi 1, "*Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar*", si dhe duke ju referuar Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 Qendrat komunale të Numërimit, neni 14 paragrafi 1 "*Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN, bëhen në pajtim me nenin 105 të LPZ, sipas procedurave të PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar*". Se pretendimet e ankuesit nuk qëndrojnë dhe ankesa është e pasafatshme rezulton fakti se në QKN, në komunën e Prizrenit, me datën 19.02.2025 në ora 17:20 është përmbyllur procesi i numërimit të votave të kandidatëve për deputetë dhe verifikimit të votave të subjekteve politike nga formularët e plotësuar në vendvotime më 9 shkurt 2025, në QKN në komunën e Prizrenit dhe se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë të përdorura për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09 shkurt 2025, janë dorëzuar nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) i komunës së Prizrenit më datën

22.02.2025, në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR). Po ashtu, pas shqyrtimit të deklaratave të vëzhguesve të cilat janë përpiluar në një format të caktuar, të bashkangjitura në ankesë gjejmë se të njëjtat nuk janë të mjaftueshme për tu konkluduar se në QKN në Prizren, ankuesi ka pasur mungesë të votave dhe rrjedhimisht pretendimet ankimore, mbështeten në pohime të vëzhguesve të caktuar të cilat nuk janë argumentuar me asnjë dokument, por këto janë vetëm pretendime të supozuara.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr. 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi I të Ligjit Nr. 05/1,-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si në vijim: A.nr.611/2025, Anr.612/2025, Anr.613/2025, Anr.614/2025, Anr.615/2025, Anr.616/2025, Anr.617/2025, Anr.618/2025, Anr.619/2025, dhe Anr.620/2025 janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët A.nr.611/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga kandidati për deputet Edmond Hoxha nga koalicioni AAK-NISMA, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shkeljen e njëjtë, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesat dhe përgjigjen në ankesë ka gjetur se :

- Ankesa është e pasafatshme.

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se kandidati për deputet nga radhët e koalicionit AAK-NISMA, Edmond Hoxha ka dorëzuar ankesat në PZAP, më datë 26.02.2025, ku ka pretenduar se ka pranuar informata nga vëzhguesit e caktuar nga koalicioni AAK-NISMA se në disa vendvotime në Prizren fletëvotimet e koalicionit AAK-NISMA përkatësisht të kandidatit me numër 98 me dashje apo pa dashje nuk janë transferuar në sistemin elektronik gjatë procesit të numërimit në QKN.

Megjithatë, ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 105 paragrafi 1 i LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesave lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR dorëzohen, me shkrim pran PZAP-së brenda 48 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, ankesat janë dorëzuar me postë me datën 22.02.2025, kurse nga hetimi i ndërmarr nga PZAP-i dhe nga përgjigja e KQZ-së, procesi i numërimit në QKN Prizren është përfunduar më datën 19.02.2025 në ora 17:20, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor prej 48 orëve.

Paneli, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga kandidati për deputet nga radhët e koalicionit AAK-NISMA Edmond Hoxha, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 105 paragrafi 1 i LZP-së, *ku afati për dorëzimin e ankesave lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR dorëzohen*, me shkrim pran PZAP-së brenda 48 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

Paneli gjeti se i njëjti është ushtruar pas afatit ligjor, dhe nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 105 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.5 të Rregullës 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A.nr. 611/2025 më datën 26.02.2025



Kryesuesi i Panelit
Ramush Bardiqi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.